

## Misioni i KNKK-së në Kosovë Reagimi ndaj COVID-19

Pas përhapjes së COVID-19 në Kosovë, Misionit të KNKK-së në Kosovë iu desh ta ndryshonte kursin e veprimeve të tij programore dhe të kalonte tek ndihma për komunitetet më të prekura. Në të vërtetë, prioritet i parë ishte ngritja e kapaciteteve të strukturave të Kryqit të Kuq për t'u përballuar me situatën dhe për të arritur tek njerëzit më në nevojë. Gjatë tërë kësaj kohe, KNKK-ja mbajti kontakte të rregullta me autoritetet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare për t'i diskutuar sfidat më urgjente lidhur me COVID-19, përfshirë menaxhimin e të vdekurve.

### Mbështetja për familjet e të zhdururve

Masat kufizuese dhe pezullimi i zgjatur i punës për shkak të pandemisë COVID-19 i prekën familjet kosovare me të ardhurat më të ulëta, përfshirë familjet e personave të zhdukur. KNKK-ja u angazhua në mbështetjen e të afërmeve të moshuar dhe familjeve më të cenueshme të personave të zhdukur me para të gatshme, për t'i lehtësuar pasojat e krizës COVID-19 dhe për t'u ndihmuar që t'i mbulonin nevojat themelore të tyre gjatë emergjencës. Të moshuarit mbi 65 vjeç u kontaktuan për t'i vlerësuar nevojat e tyre, përfshirë shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale (ShMMPS). Shumica e tyre i përmendën vështirësitë me të cilat përballeshin për t'i mbuluar nevojat themelore të tyre, siç janë barnat, mjetet higjienike dhe mbrojtëse (dorëzat dhe maskat). Deri më sot, janë kontaktuar **269** familje të personave të zhdukur, ndërsa mbi **150** janë identifikuar si familje në nevojë për ndihmë të menjëhershme, **115** nga të cilat janë mbështetur me para të gatshme. Paralelisht, dhe përdërisa ky proces po vazhdon, dhjetëra familjeve të personave të zhdukur u është ofruar mbështetje psikosociale në lidhje me COVID-19, përmes bisedave me psikologjen e KNKK-së.

### Mjekësia ligjore

Udhëzimet e KNKK-së për Menaxhimin e të Vdekurve në Kontekst të COVID-19, të cilat u botuan në mars nga Njësia Ligjore e KNKK-së, u përkthyen në shqip dhe iu shpërndanë aktorëve përkatës, përfshirë Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML-në). U përkthyen, shtypën dhe shpërndanë edhe posterë plotësues si dhe një video. Për t'u ndihmuar autoriteteve që të përballeshin me pandeminë, në një takim me bashkëbiseduesit e IML-së që u mbajt më 8 korrik, KNKK-ja i dorëzoi afro **5000** PMP, gjegjësisht mburoja të fytyrës, kapakë kirurgjikalë, pelerina izoluese për një përdorim, dorëza dhe maska N95.



KNKK-ja ia dorëzon donacionin Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML)

### Qendrat e paraburgimit

Menjëherë pas përhapjes së COVID-19 në Kosovë, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) vendosi një numër masash kufizuese, në përpjekje për ta parandaluar hyrjen dhe përhapjen e COVID-19 në qendrat e paraburgimit. Në këtë aspekt, dhe sipas kërkesës së tyre, KNKK-ja ia dhuroi ShKK-së **3270** PMP dhe artikuj higjienikë (dorëza, dezinfektues të duarve, sapun për duar dhe sapun të lëngshëm).

Veç kësaj, pas një kërkesë të ShKK-së për mbështetje, KNKK-ja i dhuroi **1600** pako me rroba për të burgosurit, ndërsa Rekomandimet e KNKK-së për Parandalimin dhe Menaxhimin e COVID-19 në Qendrat e Paraburgimit u ndanë me autoritet përkatëse të burgjeve.



KNKK-ja ia dorëzon donacionin Shërbimit Korrektues të Kosovës

### Migrimi

Autoritetet e Kosovës e kërkuan mbështetjen e KNKK-së për t'i plotësuar nevojat e migrantëve dhe azilkërkuesve. Pas kësaj, KNKK-ja, së bashku me KKK-në, në tri raste, shpërndanë artikuj higjienikë, PMP dhe rroba në Qendrën e Azilit dhe në qendrat e tjera të migrimit. Njoftimi Publik i KNKK-së për Mbrojtjen e Migrantëve përballë COVID-19 u përkthye në shqip dhe u nda me autoritetet e Kosovës.

## Mbështetja për strukturat e Kryqit të Kuq

Menjëherë pasi u raportuan rastet e para të COVID-19, KNKK-ja i ofroi mbështetje financiare, teknike dhe këshillimore Kryqit të Kuq të Kosovës (KKK-së) për t'i ndihmuar që të reagojnë ndaj nevojave të më të cenueshme dhe komuniteteve më të prekura nga kriza e shkaktuar nga pandemia. Ngjashëm, mbështetje u ofrua Kryqit të Kuq të Kosovës e Metohisë (KKKM-së) për t'i ndihmuar që t'u përgjigjej nevojave të prekura me COVID-19.



Vullnetarët e Kryqit të Kuq duke i furnizuar të moshuarit pa përkujdesje me artikuj ushqimor

Mbështetja e KNKK-së ua mundësoi vullnetarëve dhe stafit të KKK-së që të angazhoheshin në ofrimin e ndihmës për kategorinë e të moshuarve pa përkujdesje duke i furnizuar me artikujt më të nevojshëm (ushqim, artikuj higjienik dhe barna). KNKK-ja i ndau këshillat dhe mjetet e saj me vullnetarët e KKK-së të angazhuar në mbështetjen e të moshuarve gjatë krizës së COVID-19.

## Qarqet fetare

Në dy pjesë që u dorëzuan gjatë pandemisë, KNKK-ja i dhuroi Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK-ut) PMP, të cilat përfshinë maska N95/FFP2, sapun të lëngshëm, pelerina me mëngë të gjata, syza kundër mjegullimit, përparëse najloni rezistente ndaj ujit dhe dezinfektues të sipërfaqeve.

Qëllimi i këtij donacioni ishte që të shtohet siguria e imamëve të përfshirë në larjen e kufomave para varrimeve në Kosovë. KNKK-ja ia dhuroi BIK-ut edhe **100 sete me nga 5 posterë** për personelin shëndetësor dhe të tjerët të përfshirë në menaxhimin e kufomave.

Njëri nga posterët e ilustronte përdorimin e duhur të PMP-ve nga hoxhallarët gjatë larjes dhe menaxhimit të kufomave të të vdekurve nga COVID-19. BIK-ut iu nda edhe *Analiza e KNKK-së për Udhëzimet Islame për Trajtimin e Kufomave të Viktimave të Koronavirusit*, përfshirë një video në gjuhën shqipe në të cilën jepeshin



Vullnetarët e Kryqit të Kuq duke bartur artikuj ushqimorë për t'ua dërguar njerëzve në nevojë

Nëpërmjet këtij projekti, KKK-ja arriti të kontaktonte me mbi **500** të moshuar të vetmuar nga të gjitha komunitetet. Që nga marsi, KKK-ja u angazhua në shpërndarjen e mbi **3800** pakove ushqimore dhe higjienike tek komunitetet më të cenueshme. Shpenzimet e tyre lidhur me shpërndarjen, angazhimin e vullnetarëve, logjistikën e të tjera i mbështeti KNKK-ja. Në anën tjetër, KNKK-ja e financoi blerjen e mbi **800** pakove ushqimore dhe higjienike që iu shpërndanë njerëzve në nevojë si dhe blerjen e PMP-ve (dorëzave, maskave, syzeve dhe dezinfektuesve) për stafin dhe vullnetarët e KKKM-së të përfshirë në aktivitetet e KKK-së.

udhëzime për përdorimin e duhur të PMP-ve dhe procedurat që duhej ndjekur nga personeli shëndetësor dhe të tjerët të përfshirë në trajtimin e kufomave të të vdekurve nga COVID-19.



Zyrtari për Komunikim i KNKK-së dhe Këshilltari i Lartë i Presidencës së BIK-ut e diskutojnë donacionin e marrë nga KNKK-ja

## Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK)

10 000 Prishtinë, Kosovë  
Rr. Pashko Vasa, Nr. 41  
T. +383 38 403 200  
E: [pristina@icrc.org](mailto:pristina@icrc.org)  
[www.icrc.org](http://www.icrc.org)



ICRC